



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 591/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkritazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Kushtrim Haliti në cilësinë e kryesuesit të Vendvotimit 1906e/07r, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**REUZOHET** si e pabazuara ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

## A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik LVV, në të cilën pretendohet se në Qendrën e Votimit nr. 1906e/07r, Kushtrim Haliti në cilësinë e kryesuesit të Vendvotimit të cekur, gjatë procesit të numërimit të votave, ka kërcënuar me fjale vëzhguesin e LVV-së Qëndron Kastrati dhe gjithashtu i njëjti i ka asistuar votuesit në kabinën e votimit. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- **ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh, se pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se është bërë shkelja e theksuar janë të pabazuara nga shkak se nuk janë ofruar dëshmi për të

besuar se ka ndodhur shkelja e tillë. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

A nr. 591/2010 më datën 16.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**

